

PLATFORMA E INTEGRUARE KESHILLAVE STUDENTORE

PER UNIVERSITETIN

Drejtuar: Kuvendit të Shqipërisë
Kryeministrit të Shqipërisë, Z. Edi Rama
Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Znj. Besa Shahini
Universiteteve publike (UT, UPT, UBT, UMT, UA, UST, USHLG, UAMD, UGJEÇ, UV, UE, UK)

Lënda: Platforma e zgjeruar për realizimin e 8 kërkesave të studenteve.

Synimet kryesore të levizjes studentore janë **Shfuqizimi i “Ligjit të Arsimit të Lartë” dhe rritja e menjehershme e investimeve në arsimin e lartë**, duke rritur peshën që ze në PBB.

Ligji aktual i Arsimit të Lartë duhet të shfuqizohet menjehere pasi:

- Krijon një pabarazi të theksuar në mundësitë për të ndjekur arsimin e lartë, duke e kthyer këtë të fundit në privilegj dhe jo në të drejtë kushtetuese për të gjithë qytetarët pavarësisht races, etnise, perkatesisë fetare apo statusit social.
- Kufizon autonominë universitare në kundërshtim me parimin e lirise akademike të vendosur në Nenin 57 të Kushtetutës.
- Minimizon deri në zerim të plote, rolin e studenteve në jetën akademike, administrative dhe financiare të universiteteve.

Ajo çfarë ka ofruar Kryeministri Rama në lidhje me kërkesat e studenteve është absolutisht jo serioze dhe paketa e tij për zgjidhje, nuk bën gjë tjetër vetëm se thëllon edhe më tej situatën e krizës në arsimin e lartë si dhe krijon konfuzion të metejshëm tek studentët. Me në detaje po japim më poshtë një pasqyrim të plote të 8 kërkesave të studenteve dhe të pseudo zgjidhjes së ofruar nga Kryeministri.

1. KËRKESA E PARË E STUDENTËVE

Rritja e buxhetit të arsimit në 5% të GDP, me qëllim mundësimin e përgjysimit të tarifës së studimit për çdo nivel studimi, përmirësimin e infrastrukturës dhe mësimdhënies (universitete dhe konvikte).

Çfarë përfshin Pakti për Universitetin sipas Kryeministrit

- Tarifat të paguhen nga qeveria nga 100% deri në 50% me shkallëzim.
- 100% për studentët me mesatare 9 deri në 10, për studentët nga familje në ndihmë ekonomike, si edhe për të verbërit dhe studentët paraplegjikë e tetraplegjikë. Këto dy kategori mund të kenë edhe një bursë prej 10,000 lekë.
- 75% për studentët me mesatare 8 deri në 9
- 50% për studentët me mesatare 6 deri në 8

(50% po ashtu me mesatare më të ulët se sa 6, por deri në fundvitin akademik 2018-2019. Kjo bëhet për një mundësi të barabartë në një start të ri dhe për këtë arsye asnjë student, pavarësisht mesatares, nuk do të paguajë më shumë se sa 50% të tarifës deri në vitin e ardhshëm akademik).

Çfarë kërkojnë studentët:

- **Skema e shkallëzimit meritokratik do të zbatohet si për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve universitare.**
- Grantin për universitetet për përgjysmimin e tarifës së studimit në çdo nivel studimi (bachelor dhe master), duke mos cënuar qëndrueshmërinë financiare të universiteteve.
- Rritja e buxhetit për arsimin në 5% të GDP.
 - Citojmë: *Synimi është që financimi publik për arsimin të arrijë në nivelin e 5% e PBB me qëllim që të sigurohet arsim cilësor për çdo fëmijë, pavarësisht origjinës, rrethanave familjare, apo gjendjes ekonomike. "Aktualisht vetem 0.5% e buxhetit për arsimin i dedikohet Arsimit të Lartë"* Është e njohur shprehja "Më thuaj si është arsimi sot, të të them sesi do të jetë e ardhmja e e një vendi nesër".
- Qeveria duhet të dalë me një plan afatëgjatë ku duhet të synojë rritjen e buxhetit dhe të hapë fonde për përmirësimin e kushteve në Universitet.
- Në VKM Nr. 778, datë 26.12.2018, ku është ndryshuar vendimi nr. 288, datë 21.5.2018 pika 1, me qëllimin përgjysmimin e tarifave, studentët kërkojnë që ky vendim të jetë dhe për ciklin e dytë të studimeve Master por të mos bëhet me VKM por me ndryshimin e ligjit të Arsimit të Lartë (KM arriti të hiqte VKM 288 pika 4 brënda ditës dhe në këtë mënyrë mund ta anullojë dhe këtë VKM shumë thjeshtë).

- Rritja e buxhetit për IAL-të publike në masën 25%+ shtesën e duhur në buxhet për të subvencionuar tarifën në masën 50% për të gjithë studentët.
- Sa i takon përmirësimin të kushteve të jetesës së studentëve, Kryeministri, propozon: *“Në Aktin Normativ të buxhetit 2018 që pritet të miratohet së shpejti, janë parashikuar rreth 300 milionë lekë shtesë për kryerjen e investimeve në infrastrukturën e konvikteve për vitin 2019. Nëpërmjet një financimi total prej 16.8 milionë euro si më sipër, dhënë nga Qeveria Gjermane, do të mundësohet rehabilitimi i një numri maksimal prej 13 godinash të rezidencave studentore universitare në Tiranë (nga 37 godina që përllogariten të jenë në total në qytetin e Tiranës). Afati i realizimit: Brenda një periudhe 3-vjecare për ndërhyrje në rikonstrukcione.”*
- **Koment:** Me zgjidhjen e propozuar nga Kryeministri, kemi thjesht një arnim dhe jo një paketë ambicioze për sigurimin e kushteve bashkëkohore të jetesës dhe studimit të studentëve. Qeveria nuk ka ndërmend as për këtë mandat të ngrerë apo të fillojë punimet për një kampus universitar, së paku për atë të Tiranës, ku pak ditë më parë premtoi se është gati projekti dhe pritet vetëm financimi.

Afati i realizimit:

Brenda këtij viti të merren masat për rritjen e buxhetit në 5%.

Aplikimi i përgjysmimit të tarifave të ciklit Bachelor dhe Master brenda muajit Janar.

2. KËRKESA E DYTË E STUDENTËVE

Transparencë me buxhetin nga Ministria e Arsimit dhe IAL-ve, publikimi të gjitha shpenzimeve online.

Çfarë përfshin Pakti për Universitetin sipas Kryeministrit

- Të krijohet një faqe online, ku të publikohen të gjitha buxhetet dhe shpenzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë dhe çdo IAL-i publik. Faqja të shërbejë edhe si një platformë, për ekspozimin e akteve të korrupsionit apo të shkeljeve të çdo lloji në universitet.

Afati i zbatimit: Janar 2019

Çfarë kërkojnë studentët:

Me VKM nr. 781, datë 26.12.2018 u vendos të krijohet Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar ku:

Portali të jetë i aksesueshëm nga të gjithë dhe në të të publikohen on-line:

Të dhëna të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare të çdo institucioni të arsimit të lartë:

Duke filluar nga viti buxhetor 2019, bordi i administrimit të institucionit të arsimit të lartë, nëpërmjet administratorit, të përcjellë çdo tre muaj, për publikim, të dhënat e detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare sipas përcaktimit të kësaj shkronje.

- Të dhëna për buxhetin afatmesëm (PBA), buxhetin vjetor, grantin nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e tjera, të gjitha shpenzimet operative, shpenzimet për kërkim shkencor dhe shpenzimet kapitale të çdo institucioni publik të arsimit të lartë;
- Informacion për procedurat e prokurimit publik (parashikim/realizim) apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat;
- Vendimet e bordit, të senatit dhe organeve të tjera drejtuese/vendimmarrëse;
- Kuotat e parashikuara për çdo vit akademik;
- Instrumentet dhe programet e shkëmbimit studentor dhe procedurat përkatëse;
- Instrumentet e financimit të studimeve dhe procedurat përkatëse (bursat publike dhe ato specifike për çdo universitet);
- Marrëveshjet dy-apo shumëpalëshe në nivel universitetesh;
- Të dhënat për bursat dhe stimujt financiarë të ofruara nga shteti për studentët;
- CV-të e pedagogëve;
- Mekanizmat dhe procedurat për bërjen e kërkesave dhe paraqitjen e ankesave në lidhje me veprimet ose mosveprimet e drejtuesve/organeve drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, procedurën, nëpërmjet së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të institucionit të arsimit të lartë.

Problemi qëndron se: në portalin e krijuar rash.al ende nuk është hartuar asgjë konkrete, pjesë e asamblesë janë të gjithë rektorët e universiteteve si dhe Ministri i Arsimit Sportit dhe Rinisë.

- *Studentët kërkojnë që të kenë një përfaqësi në bordin e faqes online dhe studentët të zgjedhur legjitimisht nga çdo universitet.*

Afati i realizimit:

Janar 2019

3. KËRKESA E TRETË E STUDENTËVE

Rritja nga 10% në 50% e peshës totale të votës së studentëve për të zgjedhur kandidatët për dekanë, rektorë dhe çdo fakultet të ketë një përfaqësues të studentëve në senatin akademik

Çfarë përfshin Pakti për Universitetin sipas Kryeministrit

- Çdokush që ka njohuri për një praktikë ndërkombëtare, ku pesha e votës së studentëve në zgjedhjet në universitet është siç kërkohet në këtë pikë, është i lutur ta bëjë publike. Momentalisht po punohet për ta adresuar këtë pikë, duke parë me detaje çështjen e përfaqësimit të studentëve në vendimmarrje, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare.

Afati i vendimit: Janar 2019

Çfarë kërkojnë studentët:

Përfaqësimi i studentëve në Bordet Administrative dhe rritja e peshës së tyre në zgjedhjen e organeve drejtuese në Universitet.KM Rama sfidoi studentët të japin një model. Ne po i tregojmë Kryeministrit se:

1. University of Oslo:

The votes are counted separately for each group and are weighted as follows:

- Scientific staff: 53 %
- Administrative staff: 22 %
- **Students: 25 %**
- The election is conducted electronically.

2. University of Barcelona

Universiteti I Barcelonës ka peshën e votës studentore për zgjedhjen e Rektorit 30% (<http://www.ub.edu/eleccionsrektorat2016/>)

- PDI permanent doctor (51%)
- Other PDI (9%)
- **Students (30%)**
- PAS (Administrata) (10%)

- Rritja e peshës së votës së studentëve në 50% për zgjedhjen e titullareve të universitetit/fakultetit.
- Përfaqësimi i drejtë në senatin akademik ku studentët të kenë përfaqësues në varësi të numrit të studentëve për çdo fakultet.

3. Dhe sa shëmbuj të tjerë duhen për të bindur Kryeministrin që studentët mund të bëjnë me shumë kërkime dhe rezultate më konkrete se Qeveria për realizimin e 8 pikave!

Afati i realizimit:

Janar 2019

4. KËRKESA E KATËRT E STUDENTËVE

Rishikimi i titujve akademikë dhe verifikimi i teksteve mësimore.

Çfarë përfshin Pakti për Universitetin sipas Kryeministrit

- Transparenca e titujve shkencorë është aktualisht një detyrim ligjor i Universitetit. Sidoqoftë po punohet për një propozim konkret si më poshtë, që meriton të diskutohet.
- Biblioteka Kombëtare të ngrejë një portal të unifikuar, ku të hidhen të gjitha doktoraturat. Të digjitalizohen doktoraturat që janë në letër (hardcopy). Kontrolli i tyre të kryhet nëpërmjet një software-i të posaçëm dhe të gjitha rastet e dyshuara t'i kthehen Komisioneve të Posaçme Universitare për rivlerësim.
- Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë nga ana e saj, të nisë Verifikimin e Kriteve të Ligjshmërisë për titujt akademikë.

Afati i fillimit të zbatimit: Mars 2019

Çfarë kërkojnë studentët:

MASR dhe RASH, te bejne kontrollin për antiplagjiaturën. Ku është gjendur ky model? Ku e ka të shkruar RASH që vepron si një organizëm plagjiaturë? Pse nuk i jepet në dorë IAL-ve ta bëjnë dhe shteti t'i ndihmojë me softin dhe mbështetje logjistike?

Faqja rash.al momentalisht është tërësisht e boshatisur, dhe tek https://rash.al/sq/rreth-nesh/asamble_anetaresi/ mund të shikojmë që antarët kryesorë janë ministria dhe Rektoret.

Si mund të realizohet kjo kërkesë:

- Rishikimi i ligjshmërisë të titujve akademike, rishikimi i revistave ku janë botuar punimet akademike.
- Rishikimi i të gjitha gradave shkencore.
- Rishikimi i teksteve akademike të publikuara.
- Verifikimi i kriterit të mesatares për çdo pedagog + listë notash.
- Çdo Lektor, Përgjegjësit e Departamentëve, Dekanët, Rektorët duhet të deklarojnë publikisht punimet e tyre.

Afati i realizimit:

Të filloj brenda muajt Shkurt 2019

5. KËRKESA E PESTË E STUDENTËVE

Mbështetur në nenin 99 mbi Këshillat Studentore, ligji i arsimit të lartë, pika 2 kërkojmë që bordi i administrimit të IAL-eve të ketë numër të barabartë votash si nga MAS dhe IAL-t si edhe të shtohet një përfaqësues në këtë bord nga studentët.

Çfarë përfshin Pakti për Universitetin sipas Kryeministrit

- Qeveria të shkarkojë të gjithë anëtarët e bordeve të emëruar nga MASR. Anëtarët e rinj të emërohen nëpërmjet një procesi të hapur, ku figura publike dhe ekspertë me profil të lartë, të zgjidhen rojtarë të interesit publik në administrimin e Universiteteve. Po hulumtohen praktikat më të mira ndërkombëtare për të parë mundësinë që njëri prej anëtarëve të vijë nga trupa studentore.

Afati i zbatimit: Shkurt 2019

Çfarë kërkojnë studentët:

Ne VKM Nr. 782, date 26.12.2018 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të bordit të administrimit, në institucionet publike të arsimit të lartë përfaqësues të Ministrisë Përgjegjëse për Arsimin" studentët kërkojnë që të ketë ndryshime si:

- Të shkarkohen të gjithë anëtarëve të bordeve të emëruar nga Ministria e Arsimit. Emërimet e reja të bëhen me një proces të hapur dhe me vëmendje publike.
- Skema do të jetë 3 (MASR) + 3 (IAL) + 1 (i zgjedhur me votë legjitime nga studentët)
- **1** emër që do të paraqiten nga studentët për të përfaqësuar njërin nga antarët e ministrisë do të behët me zgjedhje legjitime nga çdo student dhe do të plotësojnë të njëjtat kriterë si dhe anëtarët e tjerë të bordit përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, sipas përcaktimeve të VKM Nr.782.

Afati i realizimit:

Të fillojë brenda muajt Janar 2019

6. KËRKESA E GJASHTË E STUDENTËVE

Pajisja e të gjithë studentëve me kartën e studentit brenda vitit akademik 2018 – 2019.

Çfarë përfshin Pakti për Universitetin sipas Kryeministrit

- Marrëveshja e nënshkruar në nëntor me Qendrën e Shërbimeve Arsimore Franceze, për ta bërë kartën tonë pjesë të European Student Card (ESC) është një bazë shumë e mirë për finalizimin e këtij procesi

Të miratohet VKM me shërbimet që do të ofrohen me çmim të reduktuar për studentët. Të fillojë procesi i pajisjes me Kartën e Studentit dhe të pajisen të gjithë studentët.

Afati i zbatimit: Shtator 2019

Cfarë kërkojnë studentët:

Në ligjin e Arsimit Të Lartë nr. 80/2015 neni 100 përfshihet;

1. Studentët e institucioneve publike e private të arsimit të lartë pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik. Me anë të saj studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara.
2. Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit përcakton kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit.
3. Përfitimet e studentëve nga përdorimi i kartës së studentit përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të ministrisë përkatëse që mbulon institucionin e arsimit të lartë ose njësisive të qeverisjes vendore që mbulojnë shërbimet e ofruara ndaj studentëve.
4. Kategoritë e shërbimeve që ofrojnë entet shtetërore bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje me organizma që kanë objekt të tyre interesat studentorë e me persona juridikë privatë që ofrojnë shërbime të ndryshme.

A do të mbajë përgjegjësinë për këtë shkelje të ligjit, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë dhe zyrtarët që nuk e kanë zbatuar ligjin, e kanë neglizhuar, madje e kanë shkelur me qëllim, duke lënë studentët pa një të drejtë jo privilegj që jua jep ligji?

Në Neni 141 Aktet nënligjore thuhet që duhen të miratohen brenda 9 muajve nga hyrja më fuqi e këtij ligji. **Prandaj studentët kërkojnë që të ketë persona që do të mbajnë përgjegjësi për shkeljen e ligjit**, jemi në Janar të 2019 dhe ende nuk është marrë asnjë iniciative për kartën e studentëve. Si pasojë e një shkeljeje masive të ligjit **STUDENTET KËRKOJNË QË KARTA E STUDENTIT TË DALI ME NISJEN E SEZONIT TË DYTË TË ARSIMIT TË LARTË (Mars 2019)**

Afati i realizimit:

Të ndahen Kartat e Studentëve brenda Muajt **Mars 2019!**

7. KËRKESA E SHTATË E STUDENTVE

Ndërtimi i bibliotekave me standarte Europiane dhe me libër universitar online, falas për studentët në gjuhën shqipe.

Çfarë përfshin Pakti për Universitetin sipas Kryeministrit

- Të përfundojë procesi i blerjes dhe vënies në dispozicion të studentëve të Bibliotekës Universitare Digjitale. Të gjitha Universitetet në vend do të kenë akses në bibliotekën elektronike universitare, si dhe në databazën kombëtare të doktoraturave.

Afati i zbatimit: Mars 2019

Cfarë kërkojnë studentët:

- Ngritja e sistemeve informatike nëpër Universitete.
- Biblioteka online dhe digjitalizimi i leksioneve dhe materialeve shtesë, publikimi i këtyre materialeve online nëçdo fillim semestri.
- Çfarë deklaroi KM Rama: ***“Për këtë çështje është miratuar VKM “Për ngritjen e komisionit të përcaktimit të literaturës akademike ndërkombëtare në institucionet e arsimit të lartë, që do të përkthehen në gjuhën shqipe”. Duke hedhur kështu një hap të madh në përmirësimin e titujve akademik, ne IAL-të e vendit.”***
- **Koment:** Edhe në këtë rast, pyetja për Kryeministrin është: Në cilin vend të Europës, apo vendeve të zhvilluara gjendet modeli i përcaktimit të literaturës nga një komision dhe vetëm në një gjuhë të huaj. Ritheksojmë duam literaturë në gjuhën shqipe dhe të aksesueshme për të gjithë. Universiteti në Shqipëri me Kushtetutë dhe ligjet e këtij vendi gjuhë zyrtare ka gjuhën shqipe. KM, mjafton të lëvrojë fondet për ndërtimin e bibliotekave, aksesin, mënyrën e funksionimit të tyre e zgjidhin studentët dhe organet drejtuese të universitetit. Gjithashtu KM dhe qeveria që përfaqëson do të ishin të mirëpritur të kryenin detyrimet që ju takon, për të investuar më shumë në laboratorë dhe Fakultete.
- Çdo fakultet duhet të ketë bibliotekë dhe sallë studimi me kushte bashkëkohore (Një ndër arsyet përse kërkohet rritja e buxhetit në 5%)

Afati i realizimit:

Shtator 2019

8. KËRKESA E TETË E STUDENTËVE

Vlerësimi i performancës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor i pedagogut, publikimi i tij online dhe regjistrimi i leksioneve.

Çfarë përfshin Pakti për Universitetin sipas Kryeministrit

- Të nisë vlerësimi i performancës për çdo IAL në vend, ku elementët kyç do të jenë:
 - Sondazhi Kombëtar i Studentëve për çdo pedagog, program mësimor; departament e fakultet;
 - Vlerësimi i Produktit Kërkimor për çdo departament, fakultet dhe IAL;
 - Vlerësimi i jashtëm i cilësisë, në përputhje me "Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë".

Afati i fillimit të zbatimit: Mars 2019

Çfarë kërkojnë studentët:

Ne VENDIM Nr. 783, datë 26.12.2018 u vendos që:

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë vlerëson procesin dhe performancën në mësimdhënie

- ASCAL është një faqe (www.ascal.al) e krijuar me datë 15.02.2017 dhe është tërësisht jashtë funksioni!
- Vlerësimi I Mësimdhënies nuk ka funksionuar kurrë
- Pyetëtori I Studentëve nuk ka funksionuar kurrë
- Rezultatet e Vlerësimit nuk kanë si të dalin kur nuk ka pasur Vlerësim!!!

Na ligjin e Arsimit të Lartë duhet të kryhet pyetësor për cilësinë e mësimdhënies në fund të çdo sezoni dhe në 90% të fakulteteve nuk ka ndodhur kurrë.

Studentët kërkojnë që ky vlerësim do të behët me një grup ku 70% do të jenë student, 15 % ASCAL, 15% IAL-të përkatëse.

Në VKM Nr. 783 nuk thuhet se rezultatet do të jenë publike! Për çdo pedagog që do të ketë vlerësime negative duhet të merrën masa ndëshkuese. Studentët e çdo fakulteteve do kenë të drejtë të realizojnë pyetësin në fund të çdo sezoni dhe çdo student është i detyruar të plotësojë formularin.

Duhet patjetër që rezultatet të bëhen publike dhe tek fomulari duhet të preki çdo pedagog si lektorët, shefat e dapartamenteve, dekanin dhe administratën e fakulteteve (Sekretarinë, Financën, Kancelaren etj.)

Afati i realizimit:

Janar 2019

8 +. KËRKESA TETË + E STUDENTËVE

Të zbatohen ligjet për individët: “Për statusin e të verbrit”, “Për statusin e jetimit”, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” etj. Të cilët duhet të kenë lehtësira për pagesën e tarifës vjetore.

Te pyeten dhe të konsultohet me student të cilet kanë këtë status për çdo moszbatim të ligjit dhe ndryshime të tij.

Të merren në konsiderate çdo sygjerim i studentëve me statusin, “Për statusin e të verbrit”, “Për statusin e jetimit”, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” etj.

- ***Të merren masa ligjore për personat të cilët nuk kanë zbatuar këtë ligj!***

Shtesë:

Çdo grup pune nga studentët që do të ngrihet do të jetë me votë legjitime nga pjesëmarrja e minimalisht 70% e studentëve për Fakultet!Dhe nuk do pranohet asnjë student qe mund të jetë jashtë institucioneve përkatëse të arsimit të lartë. Cdo pjestar i çdo grupi pune, është i detyruar të largohet nga strukturat politike dhe jopolitike në rast se zgjidhet në një grup pune studentor.